



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 2 Prill 2021

Nr. 201

**VENDIM**

**Objekt:** Për shqyrtimin administrativ të kallëzimit të Partisë Demokratike për shkelje të parashikuar në Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj Bashkisë Durrës.

**Kërkues:** Partia Demokratike

**Ndaj:** Bashkisë Durrës

**Baza Ligjore:** Neni 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, paragrafi 2, dhe 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi dëgjoji relacionin e administratës paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

**VËREN:**

**I.Vlerësimi paraprak**

Në ndërfaqen “Aktivitete të Ndaluar”, në rubrikën “Kallëzo”, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 02.02.2021, nga subjekti politik Partia Demokratike (PD), është raportuar denoncimi me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi 1254 datë 02.02.2021 ora 11:03 për Bashkinë Durrës, ku pretendohet se miratimi i projektvendimit të Këshillit bashkiak nr. 7, datë 28.01.2021 “Për miratimin e ndryshimit të VKB-së nr. 599, datë 11.03.2019 “Për miratimin e përdorimit të fondit vjetor prej 8.800.000 lekë për



prokurimin e sipërmarrjes private të shërbimit të mirëmbajtjes dhe ruajtjes së varrezave publike të qytetit të Durrësit” është në shkelje të nenit 91, pika 4, të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator. Përveç denoncimit në ndërfaqje, pala kallëzuese nuk ka paraqitur asnjë provë apo fakt që vërteton shkeljen e pretenduar.

Referuar denoncimit të mësipërm Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 934 prot., datë 05.02.2021, i ka kërkuar zj. Emiriana Sako, kryetar në detyrë i Bashkisë Durrës, dhe Këshillit të Bashkisë Durrës, informacion sqarues dhe kopje të njësuar të praktikës, lidhur me këtë nismë nënligjore.

Me shkresën nr. 1627/2 prot., datë 16.02.2021 Kryetari i Këshillit Bashkiak Durrës, z. Ani Dyrmishi, ka kthyer përgjigje në të cilën vë në dispozicion gjithë kopjen e njësuar me origjinalin të praktikës së ndjekur nga ky organ, për këtë nismë nënligjore.

Në përgjigjen e dhënë bëhet e ditur se, vendimi i miratuar nga Këshilli Bashkiak Durrës nr. 7, datë 28.01.2021, i pretenduar nga pala kallëzuese si në shkelje me nenin 91, pika 4, të Kodit Zgjedhor është vazhdim i dy vendimeve të mëparshme të Këshillit Bashkiak nisur në vitin 2014 dhe për rrjedhojë nuk përmbushin kushtin e projektaktit të propozuar/miratuar katër muaj para datës së zgjedhjeve për t’u konsideruar si veprimtari e kryer në mosrespektim të nenit 91/4 të Kodit Zgjedhor.

Gjithashtu në përgjigjen e dhënë citohet se *“Këshilli Bashkiak nuk ka parashikuar as rritjen e pagave, as pensioneve, as mbështetje ekonomike apo sociale, as ulje ose heqje të taksave, as vendosje të amnistive fiskale, as privatizimin apo dhënien e pasurive apo shpërblimeve, as koncensione as PPP...etj, dhe pasuria e paluajtshme do të vazhdojë të jetë e Bashkisë Durrës, tarifat do të jenë të njëjta dhe do të mbliidhen nga bashkia, punonjësit nuk do të hiqen as shtohen, por thjesht një pikë nisje për rritjen e cilësisë së shërbimeve funerale ndaj qytetarit, në këtë kohë pandemie.”*

Me shkresën nr. 1627/3 prot., datë 18.02.2021, kryetari në detyrë i Bashkisë Durrës, zj Emiriana Sako, ka kthyer përgjigje nëpërmjet së cilës bën me dije se miratimi i vendimit nr. 7, datë 28.01.2021 i Këshilli Bashkiak, për të cilin është bërë kallëzim është në vazhdim të vendimit nr. 199, datë 10.07.2014 dhe atij nr. 599, datë 11.03.2019.

Sipas zj. Emiriana Sako, Bashkia Durrës është në zbatim të plotë të detyrave të saj funksionale dhe ky vendim i miratuar prej Këshillit Bashkiak me propozimin e bashkisë, ka pasur për qëllimin e saj të vetëm dhe kryesor, përmirësimin e shërbimit ndaj qytetarëve dhe nuk përbën shkelje të nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.



Në përgjigjen e saj theksohet se respektimi formal i afatit 4 mujor të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor, nëse nuk përbën asnjë shkelje apo paragjykim që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo me fushatën zgjedhore apo mënjanimin nga njëri krah politik apo tjetër, nuk mund të jetë kurrë sesi një pengesë ligjore ku ushtrimi i detyrave të bashkisë ndaj qytetarëve të saj, pengohet apo ndalohet vetëm për shkak afati.

## II. Rrethanat e faktit

Këshilli Bashkiak, ka miratuar vendimet:

1. VKB nr. 199, datë 10.07.2014 *“Për dhënien e miratimit, Bashkisë Durrës të zhvillojë procedurat e prokurimit publik për kalimin në sipërmarrje të shërbimeve publike të mirëmbajtjes dhe ruajtjes së varrezave publike të qytetit të Durrësit”*, nëpërmjet të cilit është dhënë miratimi Bashkisë Durrës për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik për kalimin në sipërmarrje private të shërbimeve publike të mirëmbajtjes dhe ruajtjes së varrezave publike të qytetit të Durrësit.
2. VKB nr. 599, datë 11.03.2019 *“Për miratimin e përdorimit të fondit vjetor prej 8.800.000 lekë për prokurimin e sipërmarrjes private, të shërbimit të mirëmbajtjes dhe ruajtjes së varrezave publike të qytetit të Durrësit”*, nëpërmjet të cilit miratohet fondi limit për sipërmarrjen private të shërbimit të mirëmbajtjes dhe ruajtjes së varrezave publike të qytetit të Durrësit me vlerë 8.800.000 lekë në vit.
3. VKB nr. 123, datë 24.12.2020 *“Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2021, si dhe projektbuxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023”*, nëpërmjet të cilit është parashikuar në nënfunksionin 15, zëri buxhetor për mirëmbajtjen, ruajtjen dhe shërbimit e varrimit në varrezat e qytetit nga operatori ekonomik në vlerën prej 37.000.000 lekësh.
4. VKB nr. 7, datë 28.01.2021 *“Për miratimin e ndryshimit të VKB-së nr. 599, datë 11.03.2019 “Për miratimin e përdorimit të fondit vjetor prej 8.800.000 lekë për prokurimin e sipërmarrjes private të shërbimit të mirëmbajtjes dhe ruajtjes së varrezave publike të qytetit të Durrësit”*, nëpërmjet të cilit bëhet mbyllja e aktivitetit të sektorit funeral me drejtim ekonomik që funksionon pranë NSHK Durrës, dhe kalimin e shërbimeve të tij me operator ekonomik së bashku me shërbimet e mirëmbajtjes dhe ruajtjes së varrezave publike të qytetit të Durrësit.

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga palët në KQZ, Ndërrmarja e Shërbimeve Komunale Durrës, krahas sektorit buxhetor i cili financohet totalisht nga buxheti i shtetit, ka edhe sektorin ekonomik, i cili është me vetëfinancim dhe kryen procese pune si hapje-mbyllje vendvarrimesh, përgatitje hermetikësh, shitje të materialeve për kryerjen e shërbimit të varrimit etj.



Në përfundim të hetimit administrativ Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 1598 prot., datë 1.3.2021, i ka përcjellë Partisë Demokratike relacionin me gjetjet e hetimit administrativ të kallëzimit të sipërcituar.

Me shkresën nr. 1598/1prot., datë 18.3.2021 subjekti politik Partia Demokratike ka dërguar pretendimet e saj në lidhje me këto gjetje. Në konkluzion argumentojnë se: “Rezulton evidente që VKB-të nuk kanë lidhje ligjore me njëra tjetrën. Dy aktet e para i kanë përfunduar efektet. Në “Relacionin” e dërguar nga KSHZ mungon një analizë lidhur me përfundimin e (ose jo) të efekteve ligjore të VKB-ve të viteve 2014 dhe 2019.

Vendimi i VKB –së për miratimin e Buxhetit të Bashkisë nuk është momenti kur duhet të përllogaritet afati i parashikuar nga Kodi Zgjedhor, por momenti i përllogaritjes së afatit duhet të jetë momenti i propozimit të vendimit të ankimuar, sepse vetëm në këtë çast pasqyrohet vullneti i organeve të pushtetit vendorë mbi procedurën e parashikuar të privatizimit të këtij shërbimi.

Në konkluzion konstatojnë se kallëzimi i kryer nga PD Dega Durrës është i bazuar në nenin 91/4 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator , kreu i II, neni3, pika 3.

Së pari kemi të bëjmë me një projektakt të propozuar dhe miratuar brenda afatit 4 mujor nga data e zgjedhjeve

Së dyti konstatojnë se kemi të bëjmë me privatizimin e një shërbimi publik, i cili për më tepër ka si pasojë mbylljen e aktivitetit të Ndërmarrjes së Bashkisë Durrës.

Së treti konstatojnë se kemi të bëjmë me procesin e “dhënies së pasurisë publike” tek një privat, pasi “shërbimi i varrimit” nuk mund të kryhet në mungesë të posedimit të pasurisë së paluajtshme sipas parashikimeve të Kodit Civil.

### III. Analiza ligjore

Referuar nenit 91/4 të Kodit Zgjedhor që një veprimtari të jetë në shkelje të kësaj dispozite, duhet të përmbushen në mënyrë kumulative si *koha e ndalimit e cila është katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ashtu dhe kryerja e propozimit, miratimit ose nxjerrjes së akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore.*



Sa i përket datës së miratimit të këtij vendimi, kjo datë është brenda afatit 4 mujor të parashikuar nga neni 91 pika 4, i Kodit Zgjedhor.

Në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ nuk rezultoi e provuar se ky vendim është në shkelje të kushtit tjetër të përcaktuar në nenin 91 të Kodit Zgjedhor, për privatizimin e kësaj ndërmarrje. Nuk konstatohet asnjë veprim juridik për të kaluar pronësinë e aksioneve/ aseteve publike tek palët e treta dhe nuk vërehet asnjë e dhënë që të përbëjë privatizim apo dhënie të pasurisë / aseteve publike në dispozicion të të tretëve.

Nga hetimi konstatohet se Bashkia Durrës ka planifikuar kontraktimin e këtij shërbimi tek të tretët dhe nga dokumentat e administruara nuk ka të dhëna të qarta për mënyrën e kryerjes së këtij shërbimi, e cila është kompetencë e strukturave audituese për të verifikuar ligjshmërinë e tyre.

Sa i takon faktit nëse kjo veprimtari është apo jo në shkelje të nenit 1.3 shkronja “c”, të vendimit 9/2020 të Komisionit Rregullator, sipas provave të administruara, rezulton se shërbimi funeral i kaluar në sipërmarrje private, nuk përfshin vënie në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Kalimi në sipërmarrje private të shërbimeve publike të mirëmbajtjes dhe ruajtjes së varrezave publike të qytetit të Durrësit, është bërë që në vitin 2014 me vendimin nr 199, por ashtu sikurse dhe vetë në përgjigjen e saj, zj Sako pohon, edhe pse ishte në rregullim dhe vijimësi të një procedure të nisur në 2014-tën, marrja e vendimit objekt denoncimi, ishte e nevojshme pasi nuk u ndryshua vetëm vlera e fondit të vënë në dispozicion për kalimin në sektor privat të mirëmbajtjes dhe ruajtjes së varrezave publike por u shtua dhe shërbimi funeral për kalim në sipërmarrje private.

Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të vazhdojë shqyrtimin administrativ për kallëzimin e kryer nga Partia Demokratike pasi në përfundim të hetimit administrativ rezulton se, veprimtaria e Këshillit Bashkiak Durrës, nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në vendimin nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.



## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, paragrafi 2, dhe nenet 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

## V E N D O S:

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të kallëzimit ndaj Bashkisë Durrës pasi nuk konstatohen shkelje të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Ilirjan CELIBASHI**



Data: 2 Prill 2021  
Nr. 201

Për shqyrtimin administrativ të kallëzimit të Partisë Demokratike për shkelje të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror Të Zgjedhjeve ndaj Bashkisë Durrës